



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr.02/1809/2018

Në mbështetje të nenit 22 të Rregullorës 01.nr.11159/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Hanit të Elezit, bënë:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONE
Në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vlerë prej 8,500 €, për vitin 2018.

KULTURË

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha Shoqëritë Kulturore- Artistike, Organizatat kulturore të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit - Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit të cilat janë të dëshmuara për organizimin e aktiviteteve kulturore, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e tyre vjetor për vitin 2018 në politikat programore të Sektorit për Kulturë.

1	Organizatrat kulturore të regjistruara pranë DAKRS që mirren me organizimin e aktiviteteve kulturore.	Subvencionim – sipas planprogramit të DAKRS - Organizimi i aktiviteteve kulturore	1,500 €
Totali			1,500 €

RINI DHE SPORT

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha Klubet Sportive Publike të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit, Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të cilat janë të dëshmuara për promovimin, zhvillimin dhe masovizimin e sportit, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e aktiviteteve (garave) të tyre për vitin 2018, në politikat programore të Sektorit për Sport.

1	FUTBOLL – Klubet Publike të regjistruara pranë DAKRS	6,000 €
2	MUNDJE – Klubet Publike të regjistruara pranë DAKRS	1,000 €
Totali		7,000 €

Kërkesa për aplikim për të gjitha sektorët Kulturë, Rini dhe Sport duhet të përmban:

- Qëllimin e kërkesës/projektit;
- Projekt Propozimi bashkë me koston totale;
- Aplikacioni, (merret te Qendra për shërbim të qytetarëve);
- Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- Dëshmi mbi pagesën e Tatimit në pronë;
- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Federatës Përkatëse (vetëm për klubet);
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit /që përfaqëson organizatën;
- Xhirologaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së.

Data e aplikimit është nga 02.03.2018 deri 16.03.2018.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Hanit të Elezit, Qendra për shërbim të qytetarëve.

Vërejtje:

- *Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohet;*
- *Konkuruesit të cilët nuk kanë përmyllur avanset e mëparshme ndaj këtij institucioni, nuk do të merren në shqyrtim;*
- *Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen.*

**Data: 02.03.2018
Hani i Elezit**

